

FISHA E PROJEKTIT

Specializimet e avancuara në Termohidraulikë

Background	Që nga viti 2009 projekti AlbVET mbështet zbatimin e sistemit 2+1+1 në termohidraulikë, bazuar në metodën e projekteve të të nxënimit. Mbështetja e projektit për 10 shkolla profesionale ka qenë bazuar te marrëveshja dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Konfederatës Zvicerane për fazën 2 të projektit AlbVET, e detajuar më tej në një Memorandum Mirëkuptimi dhe në fishën e bashkëlidhur të projektit, nënshkruar më 8 maj 2009 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Swisscontact. Kjo fishë projekti i parapriu tashmë vazhdimin të mbështetjes për specializimet e avancuara në nivelin +1+1 në 4 shkolla të zgjedhura.	
Qëllimi i fishës së projektit	Kjo fishë projekti specifikon mbështetjen e projektit AlbVET për zbatimin e specializimeve të të avancuara në shkollat e përzgjedhura. Fisha specifikon gjithashtu modalitetet se si nxënësit e të 10 shkollave mund të marrin pjesë në specializimet e avancuara nëpërmjet rotacionit.	
Specializimet dhe profilet	Në nivelin e specializimeve të avancuara të termohidraulikës (niveli III) kualifikimi do të bëhet në dy specializime: <ul style="list-style-type: none"> • panelet diellore / ngrohja • teknikat hidrosanitare. Dy specializimet përfshihen në profilin mësimor „ Panele diellore dhe hidraulikë “, drejtimi mësimor „ Instalues i sistemeve termohidraulike “	
Projektet e të nxënimit (PN) dhe kohëzgjatja	Profili „ Panele diellore dhe hidraulikë “ përmban 2 projekte të nxënimit me një kohëzgjatje të përgjithshme prej 13 javësh:	
	PN panelet diellore / ngrohja	9 javë
	PN teknikat hidrosanitare	4 javë
Shkollat	Dy specializimet do të ofrohen nga këto shkolla:	
	Shkolla profesionale “Beqir Çela” Durrës	
	Shkolla e Ndërtimit “Karl Gega” Tiranë	
	Shkolla profesionale “Salih Ceka” Elbasan	
	Shkolla Mekanike Bujqësore Lushnjë	
Rotacioni	Në mënyrë që të gjithë nxënësve që përfundojnë nivelin e dytë të termohidraulikës në 10 shkollat e mbështetura nga projekti AlbVET t’u krijohet mundësia e specializimit në drejtimet e sipërpërmendura në nivelin e tretë, do të zbatohet skema e organizimit të projekteve të të nxënimit të nxënësve, me rotacion. Kjo do të thotë që nxënësit do të zhvillojnë lëndët e kulturës së përgjithshme dhe ato profesionale pranë shkollave të tyre, kurse projektet e të nxënimit në shkollat “Karl Gega” Tiranë, “B. Çela” Durrës, “S. Ceka” Elbasan dhe Mekanike Bujqësore Lushnjë	
Viti shkollor 2013/14	Funksionimi me profilin mësimor „ Panele diellore dhe hidraulikë “ në katër shkollat e sipërpërmendura dhe 13 javë projekte të nxënimit do të realizohet në	

	vitin shkollor 2013/14 si më poshtë:	
Profili mësimor	Panele diellore dhe hidraulikë	
Skelet-kurrikuli	Plani kuadër mësimor për profilin „Panele diellore dhe hidraulikë“ në termohidraulikë për vitin shkollor 2013–2014 është në shtojcën 1.	
Organizimi	Mësimi do të organizohet në blloqe. Teoria do të zhvillohet në klasat e shkollave përkatëse, kurse projektet e të nxënit në 4 shkollat ku janë instaluar ofiçinat përkatëse të paneleve diellore/ngrohjes dhe teknikave hidrosanitare.	
Shkollat	Durrës	1 ofiçinë për panelet diellore/ngrohje 1 ofiçinë për teknikat hidrosanitare
	Elbasan	1 ofiçinë për panelet diellore/ngrohje 1 ofiçinë për teknikat hidrosanitare
	Lushnjë	1 ofiçinë për panelet diellore/ngrohje 1 ofiçinë për teknikat hidrosanitare
	Tiranë	1 ofiçinë për panelet diellore/ngrohje 1 ofiçinë për teknikat hidrosanitare
Kohëzgjatja e projekteve të të nxënit	Në vitin shkollor 2013/14 do të zhvillohen gjithsej 13 javë projekte të nxëni.	
Plani i blloqeve mësimore	Plani i blloqeve mësimore për 10 shkollat për vitin shkollor 2013/14 jepet në shtojcë (tabela 1).	
Plani i rotacionit	Plani i rotacionit për nxënësit e të 10 shkollave për vitin shkollor 2013/14 jepet në shtojcë (tabela 2).	
Kontributi i projektit AlbVET	<p>Për realizimin e specializimeve të avancuara në termohidraulikë, projekti AlbVET do të japë kontributet e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konsulencë ndërkombëtare për hartimin e kurrikulave dhe trajnimin e mësuesve • Pajisjet e 8 ofiçinave në 4 shkollat për specializimet përkatëse • Trajnimi i mësuesve për zbatimin e të gjitha projekteve të të nxënit • Hartimi i kurrikulave për të gjitha projektet e të nxënit • Hartimi dhe publikimi i materialeve mësimore për të gjitha projektet e të nxënit. <p>Në mënyrë që viti mësimor 2013-2014 të fillojë normalisht në fushën e sistemeve të paneleve diellore dhe teknikat hidrosanitare, nga ana e projektit AlbVET po merren masat për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcaktimin e pajisjeve të nevojshme për ngritjen e ofiçinave të paneleve diellore dhe teknikave hidrosanitare në të 4 shkollat; 	

	<ul style="list-style-type: none"> • porositjen për blerjen e tyre brenda muajit prill 2013; • livrimin e këtyre pajisjeve si dhe montimin e tyre në mjediset e ofiçinave përkatëse brenda muajit qershor 2013; • kualifikimin e grupit të mësuesve dhe instruktorëve që do të realizojnë pro-jektin e ri të të nxënit të paneleve diellore/ngrohjes. Seminari i kualifikimit për panelet diellore/ngrohjen është menduar të bëhet në fillim të korrikut 2013, pasi të jenë instaluar pajisjet e këtij specializimi në ofiçinat përkatëse.
Kontributi i MASH	<p>MASH do ta mbështesë këtë komponente të projektit në këto drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Plotësimi i personelit mësikor të katër shkollave të përzgjedhura për profilin e ri mësikor si dhe caktimi i mësuesve dhe instruktorëve që do të marrin pjesë në trajnim për zbatimin praktik të projekteve të të nxënit në specializimet përkatëse. • Përgatitja dhe ofrimi i mjediseve të ofiçinave përkatëse. Secila nga shkollat e përzgjedhura duhet të verë në dispozicion dy mjedise ofiçinash me një sipërfaqe 70-100 m² secili. • Miratimi i skelet-kurrikulës dhe pilotimit të saj në vitin shkollor 2013-2014. • Mbështetja logjistike e nxënësve që do të udhëtojnë nga shkollat e tyre për të zhvilluar projektet e të nxënit pranë shkollave të përzgjedhura, ku nga ana e projektit AlbVET do të montohen ofiçinat sipas specializimeve të vendosura. <p>Në mënyrë që viti mësikor 2013-2014 të fillojë normalisht me zbatimin e meto-dës të të nxënit bazuar në projekte në fushën e sistemeve të paneleve diellore/ ngrohjes dhe teknikat hidrosanitare, MASH do të marrë masat e mëposhtëme:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Rinovimi/përshtatja e mjediseve të nevojshme të ofiçinave në shkollat “S. Ceka” Elbasan, “B. Çela” Durrës, “K. Gega” Tiranë dhe Mekanike Bujqësore Lushnjë brenda qershorit 2013. Me drejtoritë e shkollave të mësipërme është rënë dakord dhe janë përcaktuar mjediset e duhura, por ato duhet të përshtaten dhe riparohen. ▪ Pagesa e TVSH për pajisjet e reja të importuara (rreth 20’000 Euro). ▪ Plotësimi i stafit mësikor të katër shkollave që do të fillojnë në vitin shkollor 2013–2014 me sistemet e paneleve diellore/ngrohjes dhe teknikat hidrosanitare. Sikurse del edhe nga plani i blloqeve mësimore (tabela 1 në shtojcë) shkollave u shtohet kjo ngarkesë mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - shkolla Mekanike Bujqësore Lushnjë: 3 blloqe mësimore për projektin e të nxënit “Projektimi, llogaritja dhe montimi i sistemeve të paneleve diellore dhe ngrohjes”, me nga 270 orë, gjithsej 810 orë + 3 blloqe mësimore për projektin e të nxënit “Projektimi, montimi dhe prezantimi i instalimeve sanitare komplekse”, me nga 120 orë, gjithsej 360 orë. Ngarkesa totale mësimore shtesë është 810 + 360 = 1170 orë. - shkolla “Beqir Çela” Durrës: 2 blloqe mësimore për projektin e të nxënit “Projektimi, llogaritja dhe montimi i sistemeve të paneleve diellore dhe ngrohjes”, me nga 270 orë, gjithsej 540 orë + 2 blloqe mësimore për projektin e të nxënit “Projektimi, montimi dhe prezantimi i instalimeve sanitare komplekse”, me nga 120 orë, gjithsej

	<p>240 orë. Ngarkesa totale mësimore shtesë është $540 + 240 = 780$ orë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkolla "Salih Ceka" Elbasan: 4 blloqe mësimore për projektin e të nxënit "Projektimi, llogaritja dhe montimi i sistemeve të paneleve diellore dhe ngrohjes" (shkolla e Elbasanit ka dy klasa), me nga 270 orë, gjithsej 1080 orë + 4 blloqe mësimore për projektin e të nxënit "Projektimi, montimi dhe prezantimi i instalimeve sanitare komplekse", me nga 120 orë, gjithsej 480 orë. Ngarkesa totale mësimore shtesë është $1080 + 480 = 1560$ orë. - shkolla "Karl Gega" Tiranë: 3 blloqe mësimore për projektin e të nxënit "Projektimi, llogaritja dhe montimi i sistemeve të paneleve diellore dhe ngrohjes" (shkolla e Tiranës ka dy klasa), me nga 270 orë, gjithsej 810 orë + 3 blloqe mësimore për projektin e të nxënit "Projektimi, montimi dhe prezantimi i instalimeve sanitare komplekse", me nga 120 orë, gjithsej 360 orë. Ngarkesa totale mësimore shtesë është $810 + 360 = 1170$ orë ▪ Mbështetja logjistike e nxënësve që do të udhëtojnë nga shkollat e tyre për të zhvilluar projektet e të nxënit pranë shkollave të Lushnjës, Elbasanit, Durrësit dhe Tiranës me bursat dhe vendet e nevojshme në konvikt. Për çdo konvikt parashikohet një numur suplementar jo më shumë se 30 nxënës për bllokun 4 dhe 5 të projekteve të të nxënit (6 janar deri 4 prill 2014).
--	---

Tiranë, 27 mars 2013